

V E N D I M
Nr.201 , datë 22.4.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E USHTARAKËVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 27.2.1992 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve", bëhen këto ndryshime:

"a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 6 380 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 27 000 lekë në muaj.

b) Në pikën 2, paga e ushtarakëve, nxënësve dhe studentëve ushtarakë bëhet 770 lekë në muaj.

c) Në pikën 5, paragrafi 3, paga për ushtarin rezervist bëhet deri në 550 lekë në ditë.

d) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

"- shef i Shtabit të Përgjithshëm	64 350 lekë
- zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm	50 490 lekë
- drejtor i Përgjithshëm	52 360 lekë
- shef i kabinetit të ministrit	49 280 lekë
- këshilltar i ministrit	41 470 lekë

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 27.2.1992 "Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë" bëhen këto ndryshime:

"a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 6 380 lekë në muaj dhe niveli më i lartë bëhet 27 780 lekë në muaj.

b) Në pikën 3, paga e ushtarakëve të shërbimit të detyrueshëm dhe studentëve të shkollave të Ministrisë së Rendit Publik bëhet deri në 770 lekë në muaj

c) Për ushtarakët e sistemuar të Ministrisë së Rendit Publik, paga e të cilëve është përcaktuar me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave (jashtë sistemit të pagave me klasa), pagat rriten 10 për qind.

d) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

" - drejtor i Përgjithshëm i policisë	61 050 lekë
- zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i policisë	55 280 lekë
- komandant i Gardës së Republikës	55 280 lekë
- drejtor i Policisë së Burgjeve	47 850 lekë

Funksionet "Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Burgjeve" kalojnë në funksione civile.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 27.2.1992 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Kombëtar" bëhen këto ndryshime:

"a) Në pikën 1, niveli më i ulët bëhet 6 380 lekë në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 27 000 lekë në muaj.

b) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- kryetar i Shërbimit Informativ Kombëtar	82 500 lekë
- zëvendëskryetar i Shërbimit Informativ Kombëtar	56 100 lekë
- inspektor i Përgjithshëm në Shërbimin Informativ Kombëtar	56 100 lekë

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondet e miratuara nga buxheti i shtetit për vitin 1999.

5. Ky vendim i shtrinë efektet financiare nga data 1.5.1999

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko